



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:095164
Datë: 15.10.2024
Numri i dokumentit: 06300761

K.Dh.Sh.II.nr.938/24

GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbare të kreditorit “Calabria” Sh.P.K., me seli në Gjiilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ymer Huruglica, avokat nga Gjiilani, kundër debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.679/23 të datës 15.01.2024, me datën 15.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.679/23 të datës 15.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.679/23 të datës 15.01.2024, në pikën I të

dispozitivitet ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.320/22, të datës 13.04.2022, të Përmbarruesit Privat Kushtrim Musa, dhe i njejtë Urdhër ka mbet në fuqi në tërësi. Ndërsa në pikën II të dispozitivitet ka detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 487.00 Euro, në afat prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarrimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Calabria” Sh.P.K., në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.749/17 i datës 23.03.2021, ka nxjerrë urdhrin P.nr.320/22 të datës 13.04.2022, me të cilin ka obliguar debitorin që në emër të kthimit të mjeteve financiare, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 256,896.03 Euro, me interes të llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave nga data e pagesës së detyrimeve tatimore 24.07.2027, e deri në datën ku shuma e cekur referohet për pagesë në Ministri të Financave, si dhe në emër të përpilimit të propozimit të paguaj shumën prej 487.00 Euro, përfaqësuesit të kreditorit.

Përmbarruesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor P.nr.210/23 i lejuar me datën 26.05.2023.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim ndaj urdhrit përmbartimor, në të cilin ka theksuar se ATK, duke qenë në zbatim të legjislacionit tatimor, ka bërë kërkesën pranë Drejtorisë përkatëse të cilës i përket kreditori, që të bëhet ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Tutje ka shtuar se ATK është e vetëdijshme për obligimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i aplikueshëm, përkatësisht nenit 82 par.4, i Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i cili parasheh se: në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ka theksuar se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është në procedurë e sipër pranë Drejtorisë përkatëse, dhe se është vetëm çështje kohe deri në procedimin final, duke qenë se vëllimi i punëve është tejet i madh. Debitori në fund ka potencuar se duhet pasur parasysh parimin e ekonomizimit të gjykimit edhe në këtë proces, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në nenin 24 par.2 të LPP-së, t'i lihet ATK-së edhe një kohë për ekzekutimin e vendimeve meqë kjo paevitueshëm do të ndodhë.

Kreditore përmes përfaqësuesit të autorizuar, në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit, nuk kanë mbështetje në dispozitën e nenit 71 të LPP-së, përkatësisht nuk është paraqitur edhe një fakt apo provë e vetme, e cila do të justifikonte arsye për aprovimin e këtij prapësimi dhe lënien jashtë fuqie të urdhrit përmbartimor, të aprovuar nga Përmbartuesi Privat. Tutje ka shtuar se në prapësimin e debitorit konstatohet se kanë bërë kërkesë pranë drejtorisë përkatëse për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, pretendim ky që vërteton faktin se debitori jo vetëm që nuk e ka kundërshtuar propozimin për përmbartim dhe urdhrin me të cilin është lejuar përmbartimi, por thjeshtë sipas dispozitës përkatëse, vetë është deklaruar se qëndron në obligim që ta përmbushë borxhin, sipas aktgjykimit të plotfuqishëm. Po ashtu ka shtuar se është fakt se organi përmbartues mund të lejojë një afat shtesë për përmbushjen e obligimeve kreditorit, mirëpo nga prapësimi i ushtruar nga debitori, nuk është kërkuar një afat i tillë, ndërkaq sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, padyshim konstatohet se nuk kemi afat paritiv, por që ky aktgjykim duhet të përmbartohet ditën e ekzekutueshmërisë. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar, dhe të lihet në fuqi urdhri përmbartimor. I ka

kërkuar edhe shpenzimet në cilësinë e të autorizuarit të kreditorit, dhe atë në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim shumën prej 974.00 Euro.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.679/23 të datës 15.01.2024, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.320/22, të datës 13.04.2022, të Përmbarruesit Privat Kushtrim Musa, dhe i njëjti Urdhër ka mbet në fuqi në tërësi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 487.00 Euro, në afat prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi. Me arsyetim se dokumenti përmbarrimor, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.749/17 i datës 23.03.2021, në bazë të së cilit Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi

Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimi e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbarrimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbarrues në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.749/17 i datës 23.03.2021, i cili është bërë i formës së prerë me datë 28.10.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 07.04.2022, e po ashtu e i njëjti aktgjykim është e

vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me shenjën ARJ.nr.1/2022 e datës 28.02.2022, i cili në rastin konkret është dokument përmbarues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: “dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Gjykata mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase aktgjykimi është bërë i formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, andaj i plotëson kushtet për caktimin e përmbarimit në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr.938/24, me datën 15.10.2024

Gj y q t a r j a,
Franciska Zhitija Ymeri